

VENDIM
Nr.717, datë 20.10.2011

**PËR TRANSFERIMIN E 100% TË AKSIONEVE TË SHOQËRISË “HEC”, LANABREGAS”
SHA, TIRANË, TË ZOTËRUARA NGA MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE
ENERGJETIKËS, SHOQËRISË “UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE” SHA, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 2 të aktit normativ nr.4, datë 9.7.2008 “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros të këtyre ndërmarrjeve”, miratuar me ligjin nr.9967, datë 24.7.2008, të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, të ligjit nr.8482, datë 10.5.1999 “Për një shtesë në ligjin nr.8237, datë 1.9.1997 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjitë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, të ligjit nr.10 430, datë 9.6.2011 “Për krijimin e shoqërive “HEC, Ulëz - Shkopet” sh.a., “HEC, Tiranë, Lanabregas” sh.a. dhe “HEC, Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.a., dhe përcaktimin e formës e të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërive “HEC, Ulëz-Shkopet” sh.a. dhe “HEC, Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.a.”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin e 100% të aksioneve të shoqërisë “HEC, Lanabregas” sh.a., Tiranë, me aksionar të vetëm Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, shoqërisë “Ujësjiellës-kanalizimeve” sh.a., Tiranë.
2. Transferimi i aksioneve do të bëhet me anën e kontratës së shitblerjes, sipas dispozitave të Kodit Civil.
3. Vlera e transferimit të 100% të aksioneve të përcaktohet me ekspertë vlerësues dhe kontabël të autorizuar, të licencuar, dhe miratohet nga Ministri i Financave dhe Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës. Pagesa e kësaj pakete të aksioneve të bëhet me lekë.
4. Caktimi i ekspertëve, të përmendur në pikën 3 të këtij vendimi, bëhet me urdhër të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
5. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë “HEC, Lanabregas” sh.a., Tiranë, nuk ndryshon edhe pas kryerjes së këtij transferimi.
6. Të ardhurat e realizuara nga transferimi i aksioneve derdhen në Buxhetin e Shtetit.
7. Pas nënshkrimit të kontratës së shitblerjes, ngarkohet shoqëria “Ujësjiellës-kanalizime” sh.a., Tiranë, të kryejë procedurat përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi, në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe në shoqërinë “Qendra e Regjistrimit të Aksioneve” sh.a., Tiranë.
8. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Financave, shoqëria “Ujësjiellës-kanalizime” sh.a., Tiranë, shoqëria “HEC, Lanabregas” sh.a., Tiranë, Qendra Kombëtare e Regjistrimit, dhe shoqëria “Qendra e Regjistrimit të Aksioneve” sh.a., Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha